



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE
Komisioni i Prokurimit Publik



100 Vjet Pavarësi

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1.1000 Tiranë, E-mail: Kpp_info@kpp.gov.al, Tel/Fax: 04 2281 860

Nr. 884 / prot
8

Tiranë, më 22.11. 2012

L e n d a: Vendim

Drejtuar: **MINISTRISË SË EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Agjencisë së Prokurimit Publik

Operatorit ekonomik "Idi 2005" sh.p.k.

Lagja 13, Plazh

TIRANË

TIRANË

DURRËS

Baza Ligjore: Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar, neni 24/1 e vijues, VKM Nr. 469, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura", dhe "Për një ndryshim në vendimin nr.27", datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve",

Komisioni i Prokurimit Publik i mbledhur në prani të Kryetarit, Zëvendëskryetarit Znj. Lealba Pelinku dhe të anëtarëve, Z. Elton Lula, Z. Klodi Beja, Znj. Besa Ombashi, mori në shqyrtim ankesën nr. 884, të datës 23.07.2012, të paraqitur nga operatori ekonomik "Idi 2005" sh.p.k., për procedurën koncesionare me objekt: "Dhënien me koncesion të Hec Gavran", zhvilluar nga autoriteti kontraktues Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datë 18.06.2012.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e operatorit ekonomik "Idi 2005" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se subjekti ankimues rezultoi ofertues në këtë procedurë koncesionare dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet" i ndryshuar, neni 24/1 e vijues, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura" dhe për një

ndryshim në VKM nr. 27, datë 19.01.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve".

Në këto kushte, ankesa i nënshtrohet juridiksionit administrativ dhe shqyrtimi i saj është kompetencë lëndore e Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga shqyrtimi i ankesës, dokumenteve që Komisioni i Prokurimit Publik disponon në lidhje me këtë procedurë koncesionare, dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues dhe Autoriteti Kontraktues, u konstatua si vijon:

Në datë 18.06.2012 është zhvilluar procedura koncesionare me objekt "Dhënie me koncesion të Hec Gavran", nga Autoriteti Kontraktues, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Në garën koncesionare kanë marrë pjesë 2 (dy) operatorë ekonomikë dhe konkretisht:

1) Shoqëria "Edonil Konstruksion" sh.p.k.;

2) Shoqëria "Idi 2005" sh.p.k.

Në datë 16.07.2012 autoriteti kontraktues me anë të shkresës nr. 8460/28 ka njoftuar operatorin ekonomik "Idi 2005" sh.p.k., për kualifikimin e tij dhe klasifikimin në vend të dytë me 78.025 pikë.

Në datë 20.07.2012, operatori ekonomik "Idi 2005" sh.p.k., ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktues, duke kundërshtuar kualifikimin dhe klasifikimin në vend të parë të operatorit ekonomik "Edonil Konstruksion" sh.p.k.

Në datë 23.07.2012, operatori ekonomik "Idi 2005" sh.p.k., ka paraqitur ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Me anë të ankimimit të paraqitur pranë KPP-së, ankimuesi kundërshton kualifikimin dhe klasifikimin në vend të parë të shoqërisë "Edonil Konstruksion" sh.p.k.

Më konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së ankimuesi pretendon se:

1) Gjatë zhvillimit të procedurës, kur u lexua oferta e depozituar nga shoqëria "Edonil Konstruksion" sh.p.k., u vu re, se në kriterin 5 (vlera e makineri paisje dhe origjina e teknologjisë) të formularit të ofertës ishte vendosur një shifër e rreme prej 180.144 lekë/kw ose 1296 euro/kw. Ankimuesi pretendon se ky konstatim u vu re edhe nga anëtarët e KVO-së, të cilët shprehën habinë e tyre në momentin e leximit të ofertës. Sipas ankimuesit, kjo shifër është jo reale dhe e rreme, duke e argumentuar këtë fakt si më poshtë:

a) Një ofertë me kosto 1296 euro/kw vetëm për turbinë nuk mund të gjendet nga asnjë Uzinë ofertuese për tipet e turbinave në Hec-et me derivacion, që në rastin konkret janë të tipit Pelton ose Frensis;

b) Kjo ofertë është të paktën 3 – 3.3 herë më e madhe dhe ky konstatim provohet lehtë nëse merren oferta konkrete nga KVO ose nëse KVO verifikon ofertat e kompanive koncesionare që kanë ndërtuar hidrocentrale apo janë në fazën e ndërtimit ku ofertat për këto tipe turbinash dhe makineri paisjet e tjera të centralit luhaten nga 270 deri në 430 euro/kw.

c) Një shifër e tillë prej 180.144 lekë/kw ose 1296 euro/kw duket hapur që është jo reale dhe e rreme, pasi në totalin e investimeve që ka deklaruar shoqëria "Edonil Konstruksion" sh.p.k., (pika 4 e formularit të ofertës) pesha e kostos së makineri pajisjeve (origjina e teknologjisë,

pika 5 e formularit) mbulon 83.34 % të vlerës, duke lënë për punimet civile vetëm 16.66 % të vlerës totale ose 269 euro/kw;

d) Truku i shifrave për të fituar pikët në formularin e ofertës është i lexueshëm. Meqënëse vlera e makineri pajisjeve vlerësohet me pikë, kjo vlerë është rritur artificialisht, duke dhënë një shifër qesharake, teknikisht, komercialisht dhe ekonomikisht të papranueshme. Nëse KVO vlerëson shifrat në kriterin 4 dhe kriterin 5 të formularit të ofertës të dorëzuar nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., del qartë se është bërë manipulim apo falsifikim shifrash. Ankimuesi pretendon se për të mos dekonspiruar trukun e shifrave, shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., nuk ka paraqitur ofertë nga ndonjë kompani, ashtu siç kërkohet në dspk, duke shkelur kështu procedurën koncesionare.

2) Ankimuesi pretendon se shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., në ofertë ka dhënë fuqinë 2344 kw. Kjo fuqi nuk është reale dhe është manipuluar, duke e rritur artificialisht, me synim për të fituar pikët e kriterit 2 të formularit të ofertës. Sipas ankimuesit, nqs i referohemi kërkesave dhe kushteve të dspk, potenciali i fuqisë teorike për pellgun e tenderuar arrin deri në 1900 kw, pra nuk ka asnjë mundësi teorike që të merret një fuqi më e madhe se vetë potenciali teorik. Kjo ndodh vetëm në rastin kur abuzohet me prurjen llogaritëse, duke e rritur këtë artificialisht për të marrë një fuqi të tillë, ose duke rritur prurjen mesatare shumë vjeçare nëpërmjet modulit specifik të rrjedhjes së ujit. Ankimuesi pretendon se KVO duhet të bënte verifikimet për të mos i hapur rrugë një projekti me shifra abuzive dhe të rreme.

3) Ankimuesi pretendon se shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., në ofertë ka vendosur një prodhim të energjisë elektrike prej 8.700.000 kwh/vit. Ky prodhim është jo real dhe paraqet një shifër të rreme, pasi kryesisht është produkt i një fuqie abuzive dhe të rreme ashtu siç është argumentuar mësipër. Ankimuesi pretendon se ky veprim është bërë me qëllim për të fituar pikët e kriterit 1 të formularit të ofertës. Bazuar në argumentat e mësipërme, ankimuesi në ankesën e paraqitur pranë KPP-së ka kërkuar një vlerësim rigoroz të projektit me qëllim vlerësimin e drejtë të të dhënave të shoqërisë “Edonil Konstruksion” sh.p.k. Ankimuesi ka kërkuar të dijë numrin e hidrocentraleve të projektuara në skemë, modulën specifik të rrjedhjes, prurjen llogaritëse, përdorimin e çmimit për makineri pajisje në analizën ekonomike etj, të dhëna që vlerësojnë realisht projektin e ofertuar. Gjithashtu ankimuesi kërkon të dijë si janë vlerësuar pikët për lidhjen me sistemin dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, pasi atij i rezulton një vlerësim jo korrekt dhe për këtë kërkon ballafaqim me KVO-në ose sqarim të detajuar.

Përsa mësipër, operatori ekonomik ankimues, me anë të ankesës së paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kërkon rivlerësimin e procedurës së konkurrimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim hetimin administrativ të procedurës së konkurrimit, referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe bazuar në nenin 25/1, nenin të Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”, i ndryshuar, në datë 22.10.2012 ka zhvilluar një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e autoritetit kontraktues, si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankimues, ndërsa në datë 24.10.2012 ka zhvilluar një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e shoqërisë “Edonil Konstruksion” sh.p.k.

Pas zhvillimit të seancave të mësipërme dëgjimore, Komisioni i Prokurimit Publik, i mbledhur në datë 30.10.2012 ka vendosur marrjen e ekspertizës teknike me qëllim hartimin e një raporti teknik nga eksperti i pavarur, mbi propozimin teknik të paraqitur nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., për këtë procedurë koncesionare.

Duke qenë se në ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idi 2005” sh.p.k., nuk është kërkuar ekspertizë teknike për të shqyrtuar propozimin teknik të shoqërisë “Edonil Konstruksion” sh.p.k., me anë të shkresës nr. 884/5 prot., datë 31.10.2012, Komisioni i Prokurimit Publik i ka drejtuar një kërkesë shoqërisë “Idi 2005” sh.p.k., me qëllim dhënien e konfirmimit paraprak në lidhje me pagesën e ekspertit të pavarur.

Në datë 05.11.2012, me anë të shkresës nr. 884/6 prot., shoqëria “Idi 2005” sh.p.k., ka dhënë konfirmimin paraprak për pagesën e ekspertit të pavarur.

Në datë 07.11.2012, Komisioni i Prokurimit Publik ka përcaktuar Studion e Projektimit “Derbi – E” si ekspert të pavarur dhe me qëllim realizimin e Raport Ekspertizës të projektit teknik të paraqitur nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., kësaj Studio, në datë 08.11.2012 i janë vënë në dispozicion materialet e nevojshme.

Në datë 20.11.2012 Studio e Projektimit “Derbi – E” ka paraqitur Raport Ekspertizën për projektin e paraqitur nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., për procedurën koncesionare me objekt: *Dhënien me koncesion të Hec Gavran*”.

Komisioni i Prokurimit Publik

pasi dëgjoi relatorët Z. Edi Spaho, Znj. Lealba Pelinku dhe Z. Elton Lula, pas shqyrtimit të ankesës dhe të dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktues,

Arsyetoi:

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, pas shqyrtimit të ankesës, dokumenteve të paraqitura nga ankimuesi, dokumenteve të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues, pas zhvillimit të seancave dëgjimore, si dhe pas shqyrtimit të Raport Ekspertizës për projektin e paraqitur nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

1) Në lidhje me pretendimin e parë të operatorit ekonomik ankimues:

Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Edonil Konstruksion” sh.p.k., rezulton se për zërin 5 të saj “*Origjina e teknologjisë dhe Kosto për njësi e makinerive dhe pajisjeve për KW fuqi të instaluar*”, kjo shoqëri ka dhënë ofertën prej 180.144 lekë/KW.

Referuar sqarimeve të dhëna nga përfaqësuesit e autoritetit kontraktues, si dhe mbështetur në preventivin e punimeve të paraqitur nga operatori ekonomik “Edonil Konstruksion” sh.p.k., rezulton se ky ofertues për zërin 5 ka përllogaritur koston për njësi të makinerive + punimet civile, e cila jep koston për njësi investimi. Në bazë të kësaj përllogaritje, rezulton se vetëm

kosto për njësi e makinerive dhe pajisjeve të ofertuesit “Edonil Konstruksion” sh.p.k., është në vlerën prej 77.325 lekë/KW.

Gjithashtu, në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se *“pesha e kostos së makineri pajisjeve (origjina e teknologjisë, pika 5 e formularit) mbulon 83.34 % të vlerës, duke lënë për punimet civile vetëm 16.66 % të vlerës totale ose 269 euro/kw”*, pas shqyrtimit të preventivit të paraqitur nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., për këtë procedurë koncesionare, rezulton se:

Shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., ka propozuar ndërtimin e tre Hec-eve dhe konkretisht: Frankovishti – 1, Frankovishti – 2, Frankovishti – 3.

Për të tre Hec-et e propozuara nga kjo shoqëri, rezulton se:

Vlera e zërit “pajisje makineri” është në shumën: 181.250.000 lekë,

Vlera e zërit “punime ndërtim – montimi” është në shumën: 216.148.500.

Nga shqyrtimi i vlerave të mësipërme, rezulton qartë se pretendimi i mësipërm i ankimuesit për peshën e kostos së makineri pajisjeve të propozuar nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., nuk qëndron.

Bazuar në sa mësipër, gjykojmë se pretendimi i parë i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

2,3) Në lidhje me pretendimin e dytë dhe të tretë të operatorit ekonomik ankimues, gjykojmë se:

Nga shqyrtimi i Raport Ekspertizës dt.20.11.2012, të paraqitur nga Studio e Projektimit “Derbi – E” në lidhje me projektin teknik të paraqitur nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., për procedurën koncesionare me objekt: *Dhënie me koncesion të Hec Gavran*”, rezulton se:

“Nuk është respektuar kushti i DST që treguesit energjitikë (Prurje Llogaritëse, Fuqia dhe Prodhimi i energjisë elektrike) të llogariten mbi prurjet që vijnë për 100 ditë në vit. Në projekt këta tregues janë llogaritur me prurje që vijnë për 50 ditë në vit, fakt ky që pranohet edhe nga autori i projektit. Llogaritja e këtyre treguesve me prurjen llogaritëse që vjen për 50 ditë në vit ka nxjerrë tregues të rritur artificialisht, teknikisht të pabazuar dhe juridikisht duke shkelur kushtet e DST”.

Bazuar në sa mësipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se oferta teknike e paraqitur nga shoqëria “Edonil Konstruksion” sh.p.k., nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DSPK, e për rrjedhojë duhet të skualifikohet.

Bazuar në sa mësipër, gjykojmë se pretendimi i dytë dhe i tretë i operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 24/1, nenin 25 e vijues të Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe “Për një ndryshim në vendimin nr.27”, date 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”,

V e n d o s i :

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idi 2005” sh.p.k., për procedurën koncesionare me objekt: “*Dhënie me koncesion të Hec Gavran*”, zhvilluar nga autoriteti kontraktues Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datë 18.06.2012.
2. Autoriteti Kontraktues, të skualifikojë operatorin ekonomik “Edonil Konstruksion” sh.p.k., nga procedura e mësipërme koncesionare;
3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Idi 2005” sh.p.k.
4. Autoriteti Kontraktues, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, të dërgojë një informacion me shkrim brenda afateve ligjore nga marrja dijani, lidhur me zbatimin e vendimit të sipërpërmendur, duke dokumentuar veprimet e kryera;
5. Kundër këtij vendimi, ankimuesi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijani, në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.

K R Y E T A R I

EDI SPAHO